

UDHËZIM
Nr. 3, datë 21.1.2025

PËR DISA NDRYSHIME DHE NJË SHITESË NË UDHËZIMIN NR. 29, DATË 18.12.2019, “PËR KRIJIMIN DHE ADMINISTRIMIN E REGJISTRAVE SHTETËRORË TË GRADAVE SHKENCORE DHE TITUJVE AKADEMIKË TË LËSHUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, të shkronjës “g”, të pikës 2, të nenit 7 dhe të pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të vendimit nr. 112, datë 23.2.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve për fitimin e gradës shkencore ‘Doktor’ dhe të standardeve shtetërore për fitimin e titujve akademikë “Profesor i asociuar” dhe ‘Profesor’”, i ndryshuar, vendimit nr. 777, datë 26.12.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për kontrollin antiplagjiaturë të disertacioneve për fitimin e gradave shkencore”, i ndryshuar dhe urdhrit nr. 113, datë 26.3.2024, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Arsimit dhe Sportit, znj. Ana Kapaj”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

Neni 1

1. Në udhëzimin nr. 29, datë 18.12.2019, “Për krijimin dhe administrimin e regjistrave shtetërorë të gradave shkencore dhe titujve akademikë të lëshuar në Republikën e Shqipërisë”, bëhen ndryshimet dhe shtesa si më poshtë:

a) Pika 1 e kreut III ndryshon si më poshtë:

“1. Institucionet e arsimit të lartë aplikojnë në portalin unik qeveritar e-Albania sipas formularit përkatës shoqëruar me dokumentacionin për çdo gradë shkencore apo titull akademik të lëshuar prej tyre.

a) Për regjistrimin e gradës shkencore “Doktor”, aplikimi përmban:

i. emër, atësi, mbiemër, shtetësi, datëlindjen dhe gjininë e personit të cilit i jepet grada shkencore;

ii. formën e studimit;

iii. numrin e matrikullimit;

iv. temën e disertacionit;

v. datën e regjistrimit në studimet e Doktoratës;

vi. kopje elektronike të disertacionit në formatin Word dhe/ose PDF;

vii. linkun/adresën e faqes web në të cilin është publikuar disertacioni përkatës;

viii. numrin dhe datën e vendimit të jurisë/komisionit për dhënien e gradës shkencore “Doktor” dhe kopje të skanuar të këtij vendimi në formatin PDF, si dhe të procesverbalit (nëse është mbajtur një i tillë);

ix. fushën e studimit;

x. konfirmimin që është kryer kontrolli antiplagjiaturë i disertacionit të mbrojtur për fitimin e gradës shkencore “Doktor” dhe njoftimin e programit/soft-it përkatës të përdorur;

b) Për regjistrimin e titullit akademik “Profesor i asociuar” dhe “Profesor”, aplikimi përmban:

i. emër, atësi dhe mbiemër, shtetësi, datëlindjen dhe gjininë e personit të cilit i jepet titulli akademik “Profesor i asociuar”/“Profesor”;

ii. numrin dhe datën e vendimit të Komisionit për Promovimin e Personelit Akademik dhe kopje të skanuar të këtij vendimi në formatin PDF, si dhe të procesverbalit (nëse është mbajtur një i tillë);

iii. numrin dhe datën e vendimit të fitimit të gradës shkencore “Doktor”/titullit akademik “Profesor i asociuar”.”

b) Pika 2 e kreut IV, ndryshon si më poshtë:

“2. Specialisti/struktura përgjegjëse për plotësimin e regjistrit shtetëror përkatës, në rastet kur aplikimi i LAL-së nuk është sipas kërkesave të përcaktuara në kreun III, të këtij udhëzimi, njofton LAL-në për plotësimet e nevojshme, brenda një afati 10-ditor.”

c) Pika 1 e kreut V, ndryshon si më poshtë:

“1. Aplikimi për regjistrimin e gradave shkencore apo titujve akademikë në regjistrin shtetëror përkatës trajtohet nga AKKSHI, pas plotësimit nga LAL-ja të kriterëve dhe ndjekjes së procedurave të përcaktuara në kuadrin ligjor në fuqi.”

ç) Pika 4 e kreut V shfuqizohet.

d) Pas pikës 2, të kreut VI shtohet pika 2/1 me përmbajtje si më poshtë:

“2/1. Procedura e aplikimit sipas këtij udhëzimi, nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”, zbatohet pasi ministria përgjegjëse për arsimin të publikojë në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare përfundimin e zhvillimeve teknike për realizimin e procedurës në Sistemit Shqiptar i Informacionit të Kërkimit Shkencor, ACRIS.

Kërkesat dhe procedurat administrative, që janë në proces shqyrtimi nga AKKSHI, deri në momentin e implementimit dhe funksionalitetit të Sistemit Shqiptar i Informacionit të Kërkimit Shkencor, ACRIS, trajtoben dhe zhvillohen sipas dispozitave në fuqi të këtij udhëzimi, në kohën e paraqitjes së tyre.”

2. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi Ministria e Arsimit dhe Sportit, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDESMINISTËR I ARSIMIT DHE SPORTIT

Ana Kapaj